



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 29.05.2023

Nr: 158

Ora: 13:00

VENDIM

**PËR KTHIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 90, TË DEPOZITUAR NË KQZ NË DATËN 26.05.2023
NGA KOALICIONI "BASHKË FITOJMË"**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 29.05.2023, me pjesëmarrjen e:

Koli	BELE	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Subjekti zgjedhor koalicioni "Bashkë Fitojmë", përfaqësuar nga z. Endrit Braimllari

PALË E INTERESUAR: Subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë" përfaqësuar nga z. Maringlen Legisi

OBJEKT: 1. Ndryshim i vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 545, datë 23.05.2023 "Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetarin e Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë, në zonën zgjedhore Bashkia Lezhë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023".



2. Rinumërim dhe rivlerësim të votave për KZAZ-të 12 dhe 13 në bashkinë Lezhë dhe miratim i tabelës përmbledhëse për zonën zgjedhore bashkia Lezhë, duke përfshirë në të rezultatin e dalë nga rinumërimi dhe rivlerësimi i votave.

BAZË LIGJORE: Nenet 21, 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë” ka depozituar pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve kërkesën ankimore, e cila është regjistruar në regjistrin e kërkesave për masat disiplinore, me nr. 90 regj., datë 26.05.2023.

Në mbledhjen e datës 29.05.2023, ora 13:00, pas relatimit të z. Koli Bele u konstatua se kërkesa ankimore nuk i plotësonte elementet e formës të parashikuara në nenin 126, pasi është paraqitur me të meta. Konkretisht në ankim nuk është bashkëlidhur asnjë provë për të provuar pretendimet e subjektit ankues, sipas parashikimit të nenit 126, pika 1, shkronja “dh” të Kodit Zgjedhor.

Në bazë të nenit 129, pika 1, të Kodit Zgjedhor, KAS për çdo kërkesë ankimore të regjistruar bën verifikimin e ekzistencës së elementeve të formës sipas nenit 126 të Kodit Zgjedhor dhe të elementeve të përcaktuara në nenin 130 të po këtij Kodi. Në kushtet kur kërkesa ankimore objekt i kësaj procedure të plotësimit të formës dhe përmbajtjes nuk i plotëson kushtet e shkronjës “dh” të pikës 1, të nenit 126, të Kodit Zgjedhor, ajo duhet t’i kthehet për plotësimin e elementeve të formës, sipas përcaktimeve të cituara si më sipër.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “c” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve,

V E N D O S I:

1. Kthimin e kërkesës ankimore nr. 90, datë 26.05.2023 për plotësim të elementëve të formës.
2. Seanca paraprake do të zhvillohet më datë 30.05.2023, ora 13:15.
3. Ngarkohet administrata e KQZ-së me njoftimin e këtij vendimi palës në mungesë dhe me zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe përfundon me çeljen e seancës së shqyrtimit paraparak, sipas shkronjës “b”, të nenit 68 të Kodit të Procedurave Administrative.

U shpall sot më datë 29.05.2023.

Koli **BELE** - **Relator**

Elvin **LAKO** - **Anëtar**

Elvis **ÇEFA** - **Anëtar**

Ilirjan **RUSMALI** - **Anëtar**